Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
 - b) garanci bankare;
 - c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	F.V. APLIKIM ASTARI NË SIPËRFAQE MURI E TAVANI	10,000			
2.	F.V. LYERJE ME BOJË HIDROPLASTIKE E APLIKUAR NË 2 HERE	10,000			
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nëshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

ASTAR (vinovil)

Karakteristika të përgjithshme:

Astari (vinovil) është një produkt me bazë rrëshira akrilike, i tretshëm në ujë, me aftësi shumë të mirë depërtimi dhe ngjitjeje në sipërfaqe, krahasuar me astarët e zakonshëm akrilikë. Është i përshtatshëm për përdorim të brendshëm ose të jashtëm dhe mund të rilyhet duke përdorur çdo emulsion ose bojë akrilike. Ky astar ka rezistencë të lartë ndaj sipërfaqeve alkaline si suva, çimento, çimento azbesti, mure të punuara me mistri, etj. Gjithashtu, redukton ndjeshëm aftësinë përthithëse të sipërfaqeve, duke mundësuar kursim të konsiderueshëm të bojës përfundimtare dhe përmirësim të kapjes së saj në sipërfaqe.

Astar me bazë akrilik i tretshëm në ujë:

Përshkrimi	Specifikimi
Graviteti specifik	1,02 – 1,04 kg/lt.
Rendimenti i mbulimit	16-20 m ² /lt për shtresë, në varësi të porozitetit dhe aftësisë përthithëse të sipërfaqes
Hollimi	50 - 300% me ujë në varësi të natyrës dhe porozitetit të sipërfaqes.
Koha e tharjes	E thatë në prekje për 1 – 1.5 orë.
Aplikimi i shtresës së dytë	4 - 6 orë. Kjo kohëzgjatje është më e madhe në kushte të ftohta dhe të lagështa dhe për shkak se zvogëlohet shkalla përthithëse e sipërfaqes
Rezistenca ndaj ujit dhe alkalineve	4 – 8 orë pas aplikimit, në varësi të kushteve atmosferike
Klasa e POA	“Astarë lidhës”. Lloji Y. Vlera e pragut të POA = 30 gr/lt. Përbërja maksimale për produktet e gatshme = 2 gr/lt. Plotëson kërkesat e Ligjit pas vitit 2011. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikën e vlimit

BOJE HIDROPLASTIKE (CILESIA I-RE)

Karakteristika të përgjithshme:

Bojë hidroplastike mat ekologjike, e cilësisë së parë, e përshtatshme për lyerjen e mureve të brendshme, suvave, sipërfaqeve të përpunuara me mistri dhe pllakave të gipsit. Produkti karakterizohet nga aromë e ulët, bardhësi e lartë, fuqi shumë e mirë mbuluese dhe performancë e shkëlqyer në aplikim.

Boja përhapet lehtësisht në sipërfaqe, është e thjeshtë në përdorim dhe nuk krijon plasaritje pas tharjes. Ajo paraqet rezistencë të lartë ndaj alkaleve dhe rezistencë shumë të mirë ndaj larjeve të shpeshta, sipas standardeve EN 13300 dhe EN 11998, Kategoria 1.

Produkti ka përmbajtje minimale të substancave të dëmshme dhe nivel të reduktuar të përbërësve organikë të avullueshëm (POA), duke e bërë të përshtatshëm për ambiente të brendshme me kërkesa të larta higjeno–sanitare dhe ekologjike.

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Përshkrimi	Specifikimi
Shkëlqimi	Mat me indeks shkëlqimi <4 njësi në 85° dhe <3 në 60° .
Graviteti specifik	1,34 - 1,48 kg/lt, në varësi të nuancës.
Rendimenti i mbulimit	11 - 13 m ² /lt për shtresë.

Hollimi	8 - 15 % për vëllim në ujë.
Koha e tharjes	E thatë për tu prekur pas ½ - 1 orësh. Boja fiton rezistencën e saj të plotë ndaj larjes pas 3 - 4 javësh.
Rezistenca e plotë ndaj larjes	Arrin pas 3 – 4 javësh
Aplikimi i shtresës së dytë	3 - 5 orë. Këto afate kohore janë më të gjata në kushte të ftohta dhe me lagështirë.
POA	Veshje mat për mure të brendshme dhe tavane." Lloji Y. Vlera e pragut të POA-së = 30 gr/lt. Përmbajtja maksimale e POA-së për produktet e gatshme = 9,5 gr/lt. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikë vlimi
Emetimet e formaldehidit	<20 µgr/m ³ 24 orë pas aplikimit të bojës. (ISO 16000-3, ISO16000-9, CET/TS15516, EN16402)

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: Lyerje e sheshparkimeve si me poshtë:

- Parkimi nëntokësor “Sheshi Italia”
- Parkimi nëntokësor “Sheshi Skënderbej”
- Parkimi nëntokësor “Bulevardi i Ri”
- Parkimi nëntokësor “Kopshti Zoologjik”
- Parkimi nëntokësor “7 Xhuxhat”

Afatet e ekzekutimit:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	F.V. APLIKIM ASTARI NË SIPËRFAQE MURI E TAVANI	M ²	10,000	12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të MK.
2	F.V. LYERJE ME BOJË HIDROPLASTIKE E APLIKUAR NË 2 HERE	M ²	10,000	12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

1.1 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Tirana Parking, në cilësinë e institucionit përgjegjës për administrimin dhe operimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë, ka si objekt kryesor garantimin e standardeve të larta të funksionimit, sigurisë dhe cilësisë së shërbimit ndaj përdoruesve.

Në kuadër të përmirësimit të kushteve infrastrukturore dhe mirëmbajtjes së ambienteve publike, është hartuar relacioni teknik për realizimin e shërbimit në parkimet nëntokësore të administruara nga institucioni përkatës. Kjo ndërhyrje konsiston në lyerjen e ambienteve të brendshme të parkimeve nëntokësore, me qëllim përmirësimin e parametrave funksionalë, estetikë dhe higjieno-sanitarë të këtyre hapësirave. Realizimi i punimeve do të ndikojë drejtpërdrejt në krijimin e një ambienti më të pastër, më të mirëmbajtur dhe më të sigurt për përdoruesit, duke rritur njëkohësisht standardin e shërbimit dhe cilësinë vizuale të infrastrukturës urbane. Përveç aspektit estetik, ndërhyrja synon edhe rritjen e jetëgjatësisë së sipërfaqeve ekzistuese, mbrojtjen e tyre nga amortizimi dhe krijimin e kushteve më të mira të higjienës dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme.

Shërbimi parashikohet të realizohet në këto parkime nëntokësore:

- Parkimi nëntokësor “Sheshi Italia”
- Parkimi nëntokësor “Sheshi Skënderbej”
- Parkimi nëntokësor “Bulevardi i Ri”
- Parkimi nëntokësor “Kopshti Zoologjik”
- Parkimi nëntokësor “7 Xhuxhat”

1.2 QËLLIMI I KRYERJES SË SHËRBIMIT

Qëllimi i kryerjes së këtij shërbimi është përmirësimi i kushteve funksionale, estetike dhe higjieno-sanitare në parkimet nëntokësore, nëpërmjet lyerjes dhe mirëmbajtjes së ambienteve të brendshme. Kjo ndërhyrje synon krijimin e një ambienti më të pastër, më të sigurt dhe më komod për përdoruesit, si dhe rritjen e standardeve të mirëmbajtjes dhe jetëgjatësisë së infrastrukturës ekzistuese.

1.3 SPECIFIKIMET TEKNIKE

1.3.1 ASTAR (vinovil)

Karakteristika të përgjithshme:

Astari (vinovil) është një produkt me bazë rrëshira akrilike, i tretshëm në ujë, me aftësi shumë të mirë depërtimi dhe ngjitjeje në sipërfaqe, krahasuar me astarët e zakonshëm akrilikë. Është i përshtatshëm për përdorim të brendshëm ose të jashtëm dhe mund të rilyhet duke përdorur çdo emulsion ose bojë akrilike. Ky astar ka rezistencë të lartë ndaj sipërfaqeve alkaline si suva, çimento, çimento azbesti, mure të punuara me mistri, etj. Gjithashtu, redukton ndjeshëm

aftësinë përthithëse të sipërfaqeve, duke mundësuar kursim të konsiderueshëm të bojës përfundimtare dhe përmirësim të kapjes së saj në sipërfaqe.

Astar me bazë akrilik i tretshëm në ujë:

Përshkrimi	Specifikimi
Graviteti specifik	1,02 – 1,04 kg/lit.
Rendimenti i mbulimit	16-20 m ² /lit për shtresë, në varësi të porozitetit dhe aftësisë përthithëse të sipërfaqes
Hollimi	50 - 300% me ujë në varësi të natyrës dhe porozitetit të sipërfaqes.
Koha e tharjes	E thatë në prekje për 1 – 1.5 orë.
Aplikimi i shtresës së dytë	4 - 6 orë. Kjo kohëzgjatje është më e madhe në kushte të ftohta dhe të lagështa dhe për shkak se zvogëlohet shkalla përthithëse e sipërfaqes
Rezistenca ndaj ujit dhe alkalineve	4 – 8 orë pas aplikimit, në varësi të kushteve atmosferike
Klasa e POA	“Astarë lidhës”. Lloji Y. Vlera e pragut të POA = 30 gr/lit. Përbërja maksimale për produktet e gatshme = 2 gr/lit. Plotëson kërkesat e Ligjit pas vitit 2011. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikën e vlimit

1.3.2 BOJE HIDROPLASTIKE (CILESIA I-RE)

Karakteristika të përgjithshme:

Bojë hidroplastike mat ekologjike, e cilësisë së parë, e përshtatshme për lyerjen e mureve të brendshme, suvave, sipërfaqeve të përpunuara me mistri dhe pllakave të gipsit. Produkti karakterizohet nga aromë e ulët, bardhësi e lartë, fuqi shumë e mirë mbuluese dhe performancë e shkëlqyer në aplikim.

Boja përhapet lehtësisht në sipërfaqe, është e thjeshtë në përdorim dhe nuk krijon plasaritje pas tharjes. Ajo paraqet rezistencë të lartë ndaj alkaleve dhe rezistencë shumë të mirë ndaj larjeve të shpeshta, sipas standardeve EN 13300 dhe EN 11998, Kategoria 1.

Produkti ka përmbajtje minimale të substancave të dëmshme dhe nivel të reduktuar të përbërësve organikë të avullueshëm (POA), duke e bërë të përshtatshëm për ambiente të brendshme me kërkesa të larta higjeno–sanitare dhe ekologjike.

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Përshkrimi	Specifikimi
Shkëlqimi	Mat me indeks shkëlqimi <4 njësi në 85° dhe <3 në 60°.
Graviteti specifik	1,34 - 1,48 kg/lt, në varësi të nuancës.
Rendimenti i mbulimit	11 - 13 m ² /lt për shtresë.
Hollimi	8 - 15 % për vëllim në ujë.
Koha e tharjes	E thatë për tu prekur pas ½ - 1 orësh. Boja fiton rezistencën e saj të plotë ndaj larjes pas 3 - 4 javësh.
Rezistenca e plotë ndaj larjes	Arrin pas 3 – 4 javësh
Aplikimi i shtresës së dytë	3 - 5 orë. Këto afate kohore janë më të gjata në kushte të ftohta dhe me lagështirë.
POA	Veshje mat për mure të brendshme dhe tavane." Lloji Y. Vlera e pragut të POA-së = 30 gr/lt. Përmbajtja maksimale e POA-së për produktet e gatshme = 9,5 gr/lt. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikë vlimi
Emetimet e formaldehidit	<20 µgr/m ³ 24 orë pas aplikimit të bojës. (ISO 16000-3, ISO16000-9, CET/TS15516, EN16402)

1.4 PËRSHKRIMI PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË LYERJES:

Përgatitja e sipërfaqeve

Para fillimit të procesit të lyerjes, të gjitha sipërfaqet duhet të pastrohen nga pluhurat, yndyrnat, lagështia, mbetjet e bojërave ekzistuese dhe çdo papastërti tjetër që ndikon në ngjytjen e bojës. Sipërfaqet e dëmtuara ose me plasaritje duhet të riparohen dhe të trajtohen paraprakisht.

Aplikimi i astarit

Astarimi duhet të realizohet në mënyrë uniforme në të gjitha sipërfaqet, me qëllim rritjen e kapjes së bojës përfundimtare dhe uljen e përthithjes së sipërfaqes.

Aplikimi i bojës

Lyerja duhet të realizohet me minimumi dy shtresa boje hidropastike mat, pigmenti sipas nevojës së autoritetit kontraktor, duke respektuar intervalet kohore të tharjes sipas rekomandimeve teknike të produktit.

Kushtet e aplikimit

Punimet e lyerjes duhet të kryhen në kushte të përshtatshme temperature dhe lagështie, duke shmangur aplikimin në sipërfaqe të lagështa ose në ambiente me ventilim të pamjaftueshëm.

Masat e sigurisë

Gjatë kryerjes së punimeve, operatori ekonomik duhet të zbatojë të gjitha masat e sigurisë teknike dhe mbrojtjes në punë, duke garantuar sigurinë e punonjësve dhe përdoruesve të parkimeve.

Pastrimi dhe dorëzimi i ambienteve

Pas përfundimit të punimeve, ambientet duhet të dorëzohen të pastruara dhe në gjendje funksionale, pa mbetje materiale apo ndotje nga procesi i punës.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës së përlogaritur**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga **Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe këstin përkatës për vitin 2026**, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen *datat, shumat dhe shërbimet e realizuara*.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen *datat, shumat dhe shërbimet e realizuara*.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit. Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me çertifikatat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatat **ISO 9001:2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatat **ISO 14001:2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojnë këto certifikata në përputhje me zërat që ka marrë përsipër të kryejë.

Shënim: *Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë për marrjen përsipër të transportit të mallrave dhe mjeteve të nevojshme për kryerjen e shërbimit, në të gjitha vendodhjet në parkimet nëntokësore të specifikuara nga Autoriteti Kontraktor, në Termat e Referencës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë një punësim minimalisht prej **5 (pesë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

Shënim: *Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

-
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e shërbimit, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 4 (katër) bojaxhi

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

2.3.7 Të disponojë në pronësi ose me qera 2 (dy) mjete ngritëse për punimet në lartësi, me rrota për përdorim në ambiente të mbyllura, duke paraqitur dokumentin që vërteton pronësinë ose kontrata noteriale e qirasë.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

